



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	25.01.2024	05.02.2024	2024/0061

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.01.2024, OE “Pro & Co Group SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0061, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me nr. të prokurimit: "651-23-13546-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 07.12.2023; data e hapjes së ofertës: 16.01..2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve,
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 57 Sigurimi i Tenderit
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 97 i Rregullores PP, nr.001/2022

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
--	--	------------------------------	--------------------------------

		Kërkesa 1 Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit . Dëshmia 1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04/L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3.Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a.Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken. 2 dhe 3 i
--	--	---

		jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërbllim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Kopja e Certifikatës se biznesit
		Kërkesa 2 Certifikata e TVSH-s	Dëshmia 2 Kopja e certifikatës se TVSH-s
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjatë 3 viteve te fundit (2020, 2021 dhe 2022) ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 21,000,000.00 Euro.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Dëshmia 1 Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.
		Kërkesa2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku : 3,000,000,00 ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia.	Dëshmia 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në fushën ndërtimit (Ndërtimi i	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku

		larte dhe ndertimi i ulet), në vlerë të përgjithshme jo me pak se 16,000,000.00 Euro, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë. Kërkesa 2.Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme. a)Menagjeri i projekt-Inxhinier i dip.ose mastër ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv) me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët b)Një udhëheqës i punishtes-Inxhinier I diplomuar ose mastër i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standartit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët. c)Një inxhinier i diplomuar ose master i hidroteknikës, së paku 3 (tri) vite përvoj punë nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët dhe i trajnuar dhe certifikuar per instalimin e gypave dhe sigurin e kanalit), d)Një inxhinier I diplomuar ose mastër I elektroteknikës, së paku 5 (pesë) vite përvoj punë nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një	duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimiti dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Dëshmia 2. a) Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca (vitet) dhe pozicioni në kompani. CV, Diploma e noterizuar (noterizimi te prezantohet nga vete inxhinieret te noteri), kontrata e punës me punëdhënësin valide, deklarata mbi vendimin e menaxherit si dhe referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit . a,b,c,d,e,ë)
--	--	--	--

		kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët. e)Një gjeodet i diplomuar ose mastër, së paku 5 vite përvoj pune pas diplomimit. ë.) Një inxhinier i diplomuar ne menaxhimin e emergjencave ose bachelor ne menaxhimin e emergjencave me jo më pak se 1 vite përvojë pune në profesion, te kete te kryer trajnimin per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar nga MPMS. f) 4 Teknikë të dip. të ndërtimtarisë (me së paku 5 vite përvojë pune profesionale) g) Një Teknik të dip të elektroteknikës Automatike , me- pes vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) gj)OE duhet të prezantoj punëtorë të profileve të ndryshme, të certifikuar nga një Institucion i Republikës së Kosovës apo nga ndonjë kompani e licencuar , ku duhet te kete së paku nga ; dy armirues, dy latues, dy murator, dy suvatues, dy molera, dy shtrues pllakash, dy instalues për instalime elektrike, dy instalues për ujësjellës dhe kanalizim h)OE duhet të ofroj dëshmi se posedon iso standardë ISO DS CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut.	f,g) CV, diploma e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë Teknikët te noteri), kontrata e punës me ofertuesin, referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit ku dëshmon përvojën e punës prej 5 viteve. gj)çertifikata e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë Personi i certifikuar te noteri) cv, kontrata e punës me ofertuesin dhe përvoja e punës minimum 3 (tri) vite pas certifikimit. h)OE duhet të ofroj dëshmi certifikatën e ISO standardit kopje te noterizuara nga origjinali per drenazhim të dheut. Dëshmia 3.Kontrata ose
--	--	--	---

		parakontrata e punës, Diplomat ose certifikatat. Cv. Kërkesa 3. OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standartit ISO 9001, dhe i njejti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe të jetë i trajnuar për Ekspert i mjedisit. Kërkesa 4.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar. Kërkesa 5.Operatori Ekonomik duhet te kete Bazë per beton nga nje kompani e licencuar ose marreveshje per furnizim. Kërkesa 6. OE duhet te ofroj plani dinamik per realizimin e projektit. Kërkesa 7. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.	Kërkesa 4.Vlersimi i rriskut per kompani nga nje kompani e licencuar nga organi kopentent konform ligjit 04 L-161 (MPMS). 5.Licenca apo leja e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale kopje ose marreveshje per furnizim me OE e licencuar te jete origjinal ose e noterizuar nga orgjinali dhe per kete projekt). Dëshmia 6. Planit dinamik i nënshkruar dhe vulosur nga kompania Dëshmia 7. OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marreveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marreveshjen për shfrytëzim të vërtetuar(vërtetim nënshkrimi) noterizuar në
--	--	---	--

			mes qiradhënsit dhe qiramarrësit me prezence të dy palëve. Vërejtje Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.
--	--	--	---

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Pro & Co Group SH.P.K.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ka publikuar dosjen e tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, dhe pasi që OE ankues e ka tërhequr ka vërejtur dhe njëherit pretendon se AK-ja, ka vendosur kriterë diskriminuesë dhe favorizuese. Prandaj në ankesën e tij kërkon që disa kërkesa të ndryshohen /plotësohen.

Pretendimi nr.1

OE ankues pretendon se me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja nuk ka kthyer përgjigje në asnjë prej pretendimeve ankimore me arsyetimin se për të njëjtin aktivitet të prokurimit ka parashtruar ankese në OSHP, një operatore ekonomik.

Eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues për mosrespektim të dispozitave të nenit 108/A, për faktin se AK-ja nuk i është përgjigjur në pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues.

Pretendimi nr.2

OE ankues pretendon se AK-ja, në kërkesën nr. 2 pika B, ka kërkuar: **Një udhëheqës i punishtes-Inxhinier I diplomuar ose mastër i Arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standartit DIN EN 16247, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune nga data e diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku një kontratë të natyrës së ngjashme-ndërtim i lartë ose ndërtim i ulët.**

OE ankues e kundërshton kërkesën e cituar më lartë, me arsyetimin se ka kërkuar nga vetëm një person që të ketë kualifikimet e përmendura në kërkesë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka dhënë një sqarim lidhur me këtë çështje se pse janë kërkuar të gjitha këto certifikata kur kemi të bëjmë me renovim, e në veçanti pse është i nevojshëm certifikimi nga organizata FIDIC, në të cilën sipas web faqes së fidic, org rezulton se kjo organizat lëshon disa certifikata në disa fusha të biznesit dhe autoriteti kontaktues nuk e ka specifikuar se çfarë certifikimi duhet të ketë udhëheqësi i punishtes. Në vlerësim të ekspertit kërkesa për certifikim nga organizata Fidic duhet të hiqet nga kërkesa e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.3

OE ankues pretendon se AK-ja, në kërkesën nr. 2 pika H, ku ka kërkuar: **OE duhet të ofroj dëshmi se posedon iso standardë ISO DS CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut,** ndërsa si dëshmi dokumentare ka kërkuar: **OE duhet të ofroj dëshmi certifikatën e ISO standartit kopje të noterizuara nga origjinali për drenazhim të dheut.** Sipas OE ankues me këtë kërkesë AK-ja ka krijuar dykuptimësi me vet faktin se të kërkesa kërkon një person me ISO standardin e cekur më lart, ndërsa të dëshmia dokumentare ka kërkuar nga operatori ekonomik të dorëzojë ISO standardin.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë duhet të specifikohet qartë, për faktin se qëndron pretendimi i OE ankues për dykuptimësi të kësaj kërkesë.

Pretendimi nr.4

Ngjashëm sikurse të pretendimi nr. 3 OE ankues pretendon se AK-ja, ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se, me vet faktin se në kërkesën nr. 3, ka kërkuar: **OE të ketë një Lead Auditor sipas kërkesës së standartit ISO 9001, dhe i njëjti duhet të jetë i Certifikuar edhe për Siguri dhe Shëndet në punë, si dhe të jetë i trajnuar për Ekspert i mjedisit,** ndërsa si dëshmi dokumentare ka

kërkuar: **Kontrata ose parakontrata e punës, Diplomat ose certifikatat. Cv.**

Eksperti shqyrtues fillimisht sa i përket kësaj kërkesë sqaron se dëshmia dokumentare ku AK-ja, ka kërkuar **Diplomat ose certifikatat. Cv**, është në kundërshtim me kërkesën dhe njëherit nuk mund të konsiderohet si dokument ekuivalent Diploma ose certifikatat. Prandaj kjo kërkesë duhet të formulohet në mënyrë që të mos ketë paqartësi dhe dëshmia dokumentare të jetë në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.5

OE ankues pretendon se kërkesa e AK-se, e vendosur në dosje të tenderit, në piken, 2, pika ë, është kërkuar: **Një inxhinier i diplomuar në menaxhimin e emergjencave ose bachelor në menaxhimin e emergjencave me jo më pak se 1 vitë përvojë pune në profesion, të ketë të kryer trajnimin për siguri dhe shëndet në punë nga një kompani e licencuar nga MPMS.** Me këtë rast OE ankues pretendon se ka len mangësi të pjesa e dëshmisë dokumentare sepse sipas OE ankues, AK-ja, në dosje të tenderit nuk ka kërkuar kurrfarë dëshmi lidhur me trajnimin për siguri dhe shëndet në punë.

Ky pretendim i OE ankues qëndron, sepse pas ekzaminimit të dosjes së tenderit eksperti shqyrtues nuk ka vërejtur se AK-ja ka kërkuar ndonjë dëshmi lidhur me këtë kërkesë.

Pretendimi nr.6

OE ankues, pretendon se AK-ja, në dosje të tenderit në lidhje me pajisjet për realizimin e projektit ka kërkuar:

- **Lugë ngarkuese 2 - 3 t**

- **Lugë ngarkuese 5 - 6 t**
- **Eskavator minimum 5 -10 ton**
- **Kamion vetshkarkues me kran peshë bartëse 2-3 ton**
- **Autofshisë speciale për pastrim pas perfundiumit të punëve me peshë deri në 1- 3 Ton**
- **Cylinder, minimum 2.5-3t**
- **Damper 1-3 ton**
- **Eskavator me lugë ngarkuese para dhe mbrapa.**
- **Traktor me pllug dhe pijator deri 2 tone,**
- **traktor me frez deri 2 tone,**
- **Makin për ngjyrosje,**
- **Kamion për terheqjen e ujerave fekale, zhbllokimin e kanalizimit min.13,000.00kg,**

Për pajisjet e cekura më lartë, OE ankues pretendon se me vet faktin që AK-ja ka përcaktuar një minimum dhe maksimum, kufizohet pjesëmarrja e OE-ve në një aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse përcaktimi i minimumi

dhe maksimumi të peshës së një pajisje do të thotë që OE-te kanë hapësirë më të madhe të përzgjedhjes.

Në fund, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja duhet të beje korrigjimet e përmendura më lart dhe në veçanti ti formulojë sakte kërkesat e dosjes së tenderit të cilat njëherit duhet të jenë në harmoni të plot me dëshminë dokumentare dhe poashtu sa të jetë e mundur AK-ja të ndajë në disa kërkesa siç është rasti i kërkesës nr. 2, pikës B, ku AK-ja ka kërkuar katër kualifikime për një inxhinier.

Poashtu i rekomandojë AK-se, që në rast se pranon kërkesë për rishqyrtim të përgjigjet në përputhje të plot me paragrafin 9 të nenit 108/A, i cili e obligon AK-në që refuzimin e ankesës/pretendimeve ta arsyetojë me shkrim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa njoftimi për kontrat të anulohet në mënyrë që AK-ja të bëjë përmirësimet e nevojshme në harmoni me nenin 53 të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Pro & Co Group SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit**” me numër të prokurimit: “**651-23-13546-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**

Florije Rexhepi

